

program për bursë pasuniversitare

kaef

Fondi Kosovar Amerikan për Shkollim

FONDI KOSOVAR AMERIKAN PËR SHKOLLIM

Fondi Kosovar Amerikan për Shkollim (KAEF) ndan bursa për studime në nivelin e magjistraturës në Shtetet e Bashkuara. Programi synon ta ndihmojë zhvillimin afatgjatë të Kosovës duke ua bërë të mundur individëve të kualifikuar të specializohen në fushat të cilat do ta çojnë përpara zhvillimin ekonomik dhe investimet në Kosovë. Fushat e studimit përfshijnë:

- Administrimin e Biznesit
- Ekonominë
- Menaxhimin dhe Politikat e Mjedisit
- Marrëdhëniet Ndërkombëtare
- Gazetarinë dhe Komunikimin në Masë
- Drejtësinë
- Administrimin Publik
- Shëndetësinë Publike

PRRËTH



PROGRAMI PËR BURSË PASUNIVERS- ITARE I KAEF

Të gjithë kandidatët përzgjidhen përmes një procesi të garimit, i cili përfshinë shqyrtimin e aplikacioneve dhe nënshtrimin e mëvonshëm të kandidatëve testeve të standardizuara (TOEFL, GRE, GMAT) dhe intervistimin e secilit kandidat me kualifikime të larta individualisht. Të gjithë bursistët e KAEF-it pastaj do të takohen para fillimit të programeve të tyre akademike në SHBA për konferencë orientuese në Uashington. Për ta plotësuar programin akademik, KAEF gjithashtu mundëson kryerjen e punës praktike, trajnime, ngritje profesionale si dhe aktivitete plotësuese për ish-bursistët, duke përfshirë këtu edhe konferencat për ekonomi në Kosovë.

KU STUDIOJNË BURSIKËT

Këshilli Amerikan ka një rrjet të gjërë të institucioneve të dalluara me të cilat bashkëpunon anekënd Shteteve të Bashkuara. Bursistët aktual të KAEF-it studiojnë në:

- Universitetin Djuke
- Universitetin e Indianës
- Universitetin e Monterejit për Studime Ndërkombëtare
- Universitetin e Roçesterit për Teknologji
- Universitetin Xhorxh Uashington
- Universitetin e Dellauerit

Ekspertë të pranimit dhe profesorë nga universitetet amerikane e zgjedhin programin dhe universitetin, i cili më së miri u përgjigjet interesimeve akademike dhe kualifikimeve të secilit pjesëmarrës të KAEF-it.

PROGRAMIT

KUSH MUND TË KONKURROJË

Kandidatët

- Duhet të jenë banorë të Kosovës të cilësdo qoftë prejardhjeje etnike, moshe apo gjinie
- Duhet të jenë të përgatitur për t'i vijuar studimet pasuniversitare në Shtetet e Bashkuara
- Duhet të jenë të gatishëm për t'u kthyer në Kosovë pas përfundimit të programit
- Duhet ta kenë diplomën e universitetit para fillimit të studimeve në SHBA
- Duhet të kenë përvojë të duhur të punës
- Duhet ta zotërojnë gjuhën angleze të folur dhe të shkruar

PROCESI I KONKURRIMIT DHE ZGJEDHJES

Konkurrimi është i hapur dhe në bazë të meritës dhe fillon me dorëzimin e aplikacionit për bursë që mund ta gjeni në: www.kaef-online.org.

Vjeshtë – Afati i fundit për konkurrim

Dimër – Të gjitha aplikacionet shqyrtohen nga ekspertë amerikan për praninë në universitet dhe kandidatët e dalluar për bursë intervistohen dhe testohen

Pranverë – Ekspertët amerikan për praninë mbledhen sërisht për t'i dhënë rekomandimet për bursë dhe vendosje në universitet


Verë – Kandidatët të cilët e kanë marrë bursën lajmërohen

Vjeshtë – Programet akademike fillojnë

MBËSHTETJA QË OFRON PROGRAMI

Bursistët e KAEF kanë:

- 100 % mbulesën e shpenzimeve të shkollës
- Mbulesën e shpenzimeve të teksteve shkollore
- Bursën mujore
- Sigurimin shëndetësor
- Fondet për ngritje profesionale
- Mbështetjen për ish-bursistët



Për më shumë informata ju lutemi vizitoni www.kaef-online.org ose kontaktoni zyrën e Këshillit Amerikan në Prishtinë:

Këshilli Amerikan për Arsim Ndërkombëtar
Tringë Smajli NR 1/1
10000 Prishtinë, Kosovë
381-38-222-570



American Councils for International Education
1776 Massachusetts Avenue, NW
Suite 700
Washington, D.C. 20036
202-833-7522

info@kaef-online.org
www.kaef-online.org